



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Numri i lëndës: KSC-CA-2023-02

Vendosi: **Paneli i Dhomës së Gjykatës së Apelit**
Gjykatëse Mishelë Pikar
Gjykatës Kai Ambos
Gjykatëse Nina Jorgensen

Administratore: Fidelma Donlon

Data: 17 gusht 2023

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

Urdhër për Caktimin e Datës së Seancës së Apelit

Zyrës së Prokurorit të Specializuar:

Vard Ferdinandse

Mbrojtjes së Salih Mustafës:

Julius von Bone

Mbrojtëses së Viktimave:

Ani Pues

PANELI I DHOMËS SË GJYKATËS SË APELIT të Dhomave të Specializuara të Kosovës (përkatësisht, “Paneli i Gjykatës së Apelit”, “Paneli i Apelit” ose “Paneli” dhe “Dhomat e Specializuara”) ¹ në bazë të nenit 33(1)(c) të Ligjit për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar (“Ligji”) dhe rregullës 172 të Rregullores së Procedurës dhe të Provave (“Rregullorja”), lëshon këtë Urdhër.

1. Paneli vëren se rregulla 180 e Rregullores përcakton se “pas përfundimit të afateve kohore për paraqitjen e dosjeve parashikuar në rregullën 179, paneli i Gjykatës së Apelit mund të caktojë datën e seancës së apelit, nëse është e nevojshme.”²

2. Më 16 qershor 2023 përfunduan afatet për dorëzimin e parashtrimeve në lidhje me apelin e z. Salih Mustafa (Mustafa) kundër Aktgjykimit të Trupi Gjykses të shqiptuar në çështjen KSC-BC-2020-05.³ Duke pasur parasysh rrethanat specifike të kësaj çështjeje gjyqësore, Paneli është bindur se është e nevojshme të zhvillohet seancë apeli dhe rrjedhimisht e cakton për **të enjten, 26 tetor 2023, në orën 13:30, dhe të premten, 27 tetor 2023, në orën 9:30.**

¹ F00007, Vendim për Caktimin e Panelit të Gjykatës së Apelit, 7 shkurt 2023 (konfidencial, riklasifikuar si publik më 7 shkurt 2023).

² Shih edhe KCS-CA-2022-01, F00074, Urdhër për Caktimin e Datës së Seancës së Apelit, 20 tetor 2022, para. 1.

³ Shih, veçanërisht KSC-BC-2020-05, F00494/RED3/COR, Version i Redaktuar më Tej i Versionit të Korrigjuar të Versionit të Redaktuar Publik të Aktgjykimit, 8 qershor 2023 (versioni konfidencial u dorëzua më 16 dhjetor 2022) (“Aktgjykimi”) F00006/RED2, Version i Redaktuar Publik i Njoftimit të Apelit të Mbrojtjes sipas Rregullës 176 (të Rregullores së Procedurës dhe Provave) kundër Aktgjykimit të Trupit Gjykses I të 16 dhjetorit 2022, 13 shkurt 2023 (versioni konfidencial u dorëzua më 2 shkurt 2023); F00021/COR/RED2, Version Publik i Redaktuar më Tej i Versionit të Korrigjuar të Dosjes së Apelit të Mbrojtjes sipas Rregullës 179 (1) të Rregullores së Procedurës dhe të Provave (“Rregullorja”), 15 maj 2023 (versioni i pakorrigjuar konfidencial u dorëzua më 24 prill 2023, versioni i korrigjuar konfidencial u dorëzua më 2 maj 2023); F00026/RED2, Version Publik i Redaktuar më Tej i Përgjigjes së Mbrojtjes së Viktimave ndaj Dosjes së Apelit të Mbrojtjes F00021, 3 korrik 2023 (versioni konfidencial u dorëzua më 5 qershor 2023); F00027/RED/COR, Versioni i Korrigjuar i Versionit të Redaktuar Publik të Dosjes së Përgjigjes së Prokurorisë ndaj Apelit të Mbrojtjes, KSC-CA-2023-02/F00027/RED, 23 qershor 2023 (versioni i pakorrigjuar konfidencial u dorëzua më 5 qershor 2023, versioni i pakorrigjuar i redaktuar publik u dorëzua më 21 qershor 2023); F00028/RED, Version i Redaktuar Publik i Dosjes së Kundërpërgjigjes së Mbrojtjes ndaj Dosjes së Përgjigjes së Prokurorisë në lidhje me Apelin e Mbrojtjes dhe Përgjigjen e Mbrojtjes së Viktimave ndaj Dosjes së Apelit të Mbrojtjes F00021, 3 korrik 2023 (versioni konfidencial u dorëzua më 16 qershor 2023).

3. Gjithashtu, në varësi të ndryshimeve, sipas rastit, orari i seancës së apelit jepet më poshtë. Në lidhje me këtë, Paneli vë në dukje se koha në dispozicion për parashtrimet, përgjigjet dhe kundërpërgjigjet përfshin edhe pyetjet që mund të ketë Paneli gjatë seancës.

E enjte, 26 tetor 2023

13:30-13:40 – Deklarata hyrëse e Kryegjykatëses (10 minuta)

13:40-15:10 – Parashtrimet e Mbrojtjes (1 orë e 30 minuta)

15:10-15:40 – *Pushim (30 minuta)*

15:40-17:10 – Përgjigjja e ZPS-së (1 orë e 30 minuta)

E premte, 27 tetor 2023

9:30-10:30 – Përgjigjja e Mbrojtëses së Viktimave (1 orë)

10:30-10:50 – Kundërpërgjigjja e Mbrojtjes (20 minuta)

10:50-11:00 – Fjala e mundshme e z. Mustafa (10 minuta)

11:00-11:05 – Deklarata përmbyllëse e Kryegjykatëses (5 minuta)

4. Së fundi, në përputhje me rregullat 68 dhe 173 (3) të Rregullores, Paneli udhëzon Mbrojtjen që **deri të hënën, 16 tetor 2023, ora 16:00**, të njoftojë me postë elektronike Njësinë e Administrimit të Gjykatës nëse i akuzuari dëshiron të marrë pjesë në seancën e apelit, dhe/ose nëse i akuzuari dëshiron të marrë pjesë nëpërmjet videokonferencës. Në rast se i akuzuari nuk dëshiron të marrë pjesë në seancën e apelit, Mbrojtja duhet të dorëzojë në të njëjtën mënyrë dhe brenda të njëjtës datë dhe orë parashtrimet përkatëse për mospjesëmarrjen.

5. Për arsyet e lartpërmendura, Paneli i Gjykatës së Apelit:

CAKTON mbajtjen e seancës së apelit për **të enjten, 26 tetor 2023, në orën 13:30** dhe **të premten, 27 tetor 2023, në orën 09:30**; dhe

UDHËZON Mbrojtjen që të njoftojë brenda **të hënës, 16 tetor, ora 16:00**, dhe në formën e përcaktuar në paragrafin 4 më lart, nëse i akuzuari dëshiron të marrë pjesë në seancën e apelit dhe, nëse është e nevojshme, të paraqesë parashtrimet përkatëse për mospjesëmarrjen.

/nënshkrimi/

Gjykatëse Mishelë Pikar
Kryegjykatëse

E enjte, 17 gusht 2023

Hagë, Holandë.